

---

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“EK&AK” SHPK**

---

**EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA**  
**NENI 1.**

**KRIJIMI, EMËRTIMI I SHOQËRISË.**

- 1.1 Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "EK&AK" Shpk në vijim e quajtur "Shoqëria".
- 1.2. Shoqëria themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar identifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**NENI 2.**

**SELIA.**


- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Bajram Curri", banesa me numër 2 kati 0, pranë lulishte "1 Maji", pasuria nr. 2 / 5 + 1 - N1.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selise së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të hapë zyrë përfaqësie, degë, dhe/ose të krijojë filiale brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3.**

**KOHËZGJATJA.**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të përcaktuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, duke filluar nga rregjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

**NENI 4.**



2

## OBJEKTI I SHOQËRISË.

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

- Tregtia me pakicë e veshjeve dhe aksesorëve
- Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara

4.2 Për të arritur objektin të saj, Shoqëria, me vendim të Asamblesë mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja.

4.3 Shoqëria, dhe me qëllim arritjen e objektit të saj, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që do ta konsiderojë të nevojshëm.

## KAPITALI.

### PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË

#### NENI 5.

#### KAPITALI THEMELTAR.

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 1 kuotë. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### NENI 6.

#### ORTAKËT.

6.1 Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët e shoqërisë :

- Ermal Kreka, shtetas shqiptar, i lindur më datë 28.04.1988, në Pogradec identifikuar me nr.personal 180428011A, madhore e me

zotësi të plotë juridike për të vepruar. Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë 50.000 lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Anton Kola, shtetas shqiptar, i lindur më datë 30.12.1992, në Xhuxhë, Mirditë identifikuar me nr.personal J21230030G, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë 50.000 lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## NENI 7.

### TRANSFERIMI I KUOTAVE.

7.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme me miratim paraprak të asamblesë së ortakëve.

7.2 Transferimi i kuotave duhet të realizohet në përputhje me ligjin dhe të regjistrohet në QKB sipas parashikimeve ligjore.

## NENI 8.

### FINANCIMI I SHOQËRISË.

8.1. Shoqëria me qellim arritjen e objektit te saj, do të kërkojë financimin nëpërmjet mënyrave ligjore si kredi bankare, hua, financim nga ortakët dhe çdo formë tjetër ligjore.

## NENI 9.

### ORGANET E SHOQËRISË.

- 9.1 Organet e Shoqërisë janë:
- Administratori,
  - Asambleja e Ortakëve.

## NENI 10.

### ADMINISTRATORËR



## FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT.

10.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator. Administratori është i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet tregtare të shoqërisë pa kufizim kompetencash, përveç atyre që ligji, akti i themelimit dhe statuti ia ngarkon Asamblesë së Ortakëve.

10.2 Administratori i shoqërisë kryen administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë. Shoqëria ka si administrator z. Ermal Kreka, shtetas shqiptar, i lindur më datë 28.04.1988, në Pogradec identifikuar me nr.personal I80428011A, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

10.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për përfaqësuar shoqërinë në marrëdhënie me të tretët. Ai vepron në emër të shoqërisë dhe nënshkruan çdo dokument të shoqërisë. Administratori nuk ushtron kompetencat që ligji ose aktet e shoqërisë ja japin shprehimisht Asamblesë së Ortakëve. Administratori emërohet për një afat 3 (tre) vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

10.4 Administratori mund të autorizoj një person të kryejë veprim në QKB si depozitim aktesh, vendimesh, bilance, statutit dhe çdo akte tjetër.

10.5. Administratori përfiton shpërblim/pagesa për punën e tyre me në masën e përcaktuar me vendim të asamblesë së ortakëve.

10.6. Administratori ka të drejtë të delegojë aksionerit të gjitha të drejtat sikur të ishte ai vet në lidhje me të gjitha institucionet financiare, drejtoritë e tatimeve, bankat etj .

## NENI 11.

### ASAMBLEJA E ORTAKËVE.

11.1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë i shoqërisë dhe vendos për çdo çështje që ligji ose ky statut ia rezervon asaj. Vendimet e Asamblesë janë të detyrueshme të zbatohen nga organet e shoqërisë.

11.2. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve organizohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

11.3. Asambleja zhvillohet ne mënyrë te rregullt dhe vendos ne mënyrë te rregullt sipas kuorumit te parashikuar nga ligji.

11.4. Mbledhjet e Asamblesë zhvillohen normalisht ne selinë e shoqërisë por, me vendim të sajin Asambleja mund te mblidhet edhe ne një vend tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë.

11.5. Ortakët njoftohen për mbledhjen e asamblesë te paktën 7 dite përpara dhe duhet te marrin njoftimin per datën, orën, vendin, rendin e ditës dhe te marrin kopjen e dokumenteve që lidhen me rendin e ditës.

11.6. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve mund të thirren nga Administratori/ administratorët, ose nga subjekte të parashikuar ne ligj.

## NENI 12.

### VITI FINANCIAR.

12.1. Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

12.2. Bilanci i shoqërisë mbahet në përputhje me ligjin, miratimi dhe cdo veprim tjetër merret në përputhje me parashikimet ligjore.

## NENI 13.

### PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË.

13.1. Procedura e likuidimit e parashikuar ne ligjin nr. 99 01, date 22.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" zbatohet ne rastin e prishjes se shoqërisë.

13.2. Shoqëria prishet ne rastet e mëposhtëme: me vendim të asamblesë; me hapjen e procedurave të falimentimit; me vendim gjykate; dhe për çdo arsye tjetër parashikuar në akte të shoqërisë ose në legjislacionin shqiptar.

### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

## NENI 14.

### LIGJI I ZBATUESHËM.

14.1. Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë statut dhe me parashikimet e ligjeve shqiptare. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut do të zbatohet ligji shqiptar nr. 9901, datë 22.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

14.2. Ky akt themelimi dhe statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 kopje origjinale sot më 13.02.2023, në Tiranë.

**ORTAKE**

**Ermal KREKA**

Ermal kreka



**ORTAKE**

**Anton KOLA**

Anton Kola

